Ramiz BERISHA
allgemein beeidigter und gerichtlich zertifizierter Dolmetscher
A-9061 Klagenfurt, Aberlgasse

Formulari ZS-QU2 "Deklarim i personave juridik për qëllime të marrëveshjes mbi tatimin e dyfishtë - lehtësim nga tatimet e burimit"

PYETJET E SHPESHTA TË PARASHTRUARA

Pyetje të përgjithshme

Çfarë qëllimi ka formulari ZS-QU2?
Për çdo pagesë përfituesi duhet të paguaj 25% tatim nga fitimi i kapitalit i ashtuquajtur ("KESt"). Projekte në shtetet, që kanë marrëveshje mbi tatimin e dyfishtë me Austrinë, janë të liruara nga tatimi apo janë për tu tatuar me një përqindje të ulët. Ju lutem plotësoni këtë formular në mënyrë korrekte, me qëllim që t'ju shmangeni pagesës së tatimit të pa nevojshëm.

Pse organizata (kompania) ime duhet ta plotësojë këtë formularë?
Organizata (kompania) e juaj vepron në një shtet, e cila ka një marrëveshje mbi tatimin e dyfishtë me Austrinë. Varësisht sipas rregullores së marrëveshjes projekti i juaj është i liruar nga tatimi i fitimit të kapitalit apo ka për tu tatuar me një përqindje të ulët.

A mund të përdorën të dhënat e mia për qëllime tjera përpos KESt (tatimi nga fitimi i kapitalit)?
Jo. Qëllimi i vetëm për mbledhjen e këtyre informacioneve shërben vetëm për lirimin e pagesës të KESt (tatimi nga fitimi i kapitalit).

Pyetjet nga formulari sipas radhës së të dhënave

Emrin e shtetit tjetër kontraktues
Ju lutem shënoni emrin e shtetit tuaj.

Kapitulli I. Të dhënat mbi personin që është përfituese/përfitues i të ardhurave
Çfarë duhet plotësuar nën pikën a)?
Emri zyrtar i organizatës (kompanisë) tuaj dhe forma juridike.

Çfarë duhet plotësuar nën pikën b)?
Adresën e saktë ku ndodhet drejtoria e organizatës (kompanisë).

Çfarë duhet plotësuar nën pikën c)?
Shtetin, aty ku është themeluar organizata (kompania) e juaj.

Çfarë duhet plotësuar nën pikën d)?
Ju lutem kryqëzoni me „**po**", nëse organizata (kompania) e juaj faktikisht vepron si organizatë jofitimprurëse (për shembull jo vetëm administrim i pasurisë apo pjesëmarrës në kompanitë tjera).

Çfarë duhet plotësuar nën pikën e)?
Ju lutem kryqëzoni me „**po**". Kjo pikë duhet të vërtetohet, që organizata (kompania) e juaj faktikisht ekziston (jo vetëm formalisht në letër apo si kompani e kutisë së postës). Bashkëpunëtorët mund të jenë të punësuar si profesionalist të lirë dhe hapësirat e objektit të ndërmarrjes mund të jenë të marra me qira.

Ajo që i takon kapitullit II. dhe III.: Ekzistojnë versione të ndryshme të formularit ZS-QU2, në të cilat në kapitullin II. dhe III. janë ndërruar pikat, mirëpo përmbajtja në të gjitha versionet është identike.

Kapitulli II. Deklarimi i përfitueses/e përfituesit të të ardhurave
Çfarë vërtetoj unë këtu?
Ju vërtetoni këtu, që organizata (kompania) juaj është ajo, e cila faktikisht merr mjete të hollash dhe jo një palë tjetër e tretë. Ju lutëm nënshkruani (firmosni) ju dhe shënoni vendin dhe datën.

Kush duhet të nënshkruaj (firmos)?
Vetëm një person i cili është autorizuar nga organizata (kompania) ka të drejtë të nënshkruaj (firmos).

Kapitulli III. Të dhënat për lehtësimin e tatimit nga të ardhurat austriake
Çfarë duhet plotësuar nën pikën a)?
Ju lutem shënoni „ERSTE Stiftung, Friedrichstr. 10, 1010 Wien".

Çfarë duhet plotësuar nën pikën b)?
Ju lutëm shënoni „Subvencion".

Çfarë duhet plotësuar nën pikën c)?
Ju lutëm shënoni shumën e tërë të ndihmës, të cilën e keni marrë nga ERSTE Stiftung (ERSTE Fondacion).

Kapitulli IV. Vërtetimin e vendqëndrimit të administratës tatimore të shtetit vendqëndrues
(Kur) A duhet unë të nxjerr këtë vërtetim?
Ky vërtetim i administratës tatimore është i obliguar, nëse subvencioni (kapitulli II.c)) kalon shumën prej 10.000 euro.

Çfarë qëllimi ka ky vërtetim?
Ky vërtetim dëshmon, që organizata (kompania) e juaj faktikisht e shënuar nën pikën I.c) shtetin (do të thotë shtetin e vendqëndrimit tuaj) në kuptim të marrëveshjes mbi tatimin e dyfishtë të të ardhurave mes Austrisë dhe shtetit tuaj që është i obliguar për tatim. Autoriteti i financës tuaj është i informuar për këtë marrëveshje dhe din, se çfarë është për tu vërtetuar.

Kush duhet të nënshkruaj (firmos)?
Ky vërtetim mund të lëshohet vetëm nga autoritetet zyrtare të financës të shtetit vendqëndrues tuajin, zakonisht nga autoriteti i financës që është kompetent për organizatën (kompaninë) tuaj.

A ka mundësi që unë apo një notar apo një drejtor i degës së financës time të nënshkruaj (firmos)?
Jo. Vërtetimi mund të lëshohet vetëm nga autoriteti zyrtar i financës i shtetit vendqëndrues tuaj.

A ka mundësi autoriteti i financës time këtë vërtetim ta lëshoi nga formularët e tija që posedon?
Jo. Vërtetimi duhet të jetë i plotësuar direkt në formularin ZS-QU2 (në atë, që ju e keni plotësuar). Ngase të gjitha autoritetet e financës nuk e bëjnë këtë në mënyrë automatike, për atë ne i shtojmë formularit edhe një fletëmbulesë, e cila përmban kërkesën përkatëse për autoritetin e financës. Me keqardhje vërtetimet të cilat janë lëshuar me një formular tjetër, nga autoritetet e financës austriake nuk pranohen.

Si mund të veproj unë, për marrjen e këtij vërtetimi?
Kjo varet nga mënyra e veprimit të autoritetit të financës tuaj. Sipas rregullores duheni ju ta plotësoni formularin tërësisht dhe pastaj për ta vërtetuar duheni ta dërgoni te autoriteti i financës tuaj apo ta dorëzoni atje.